



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR. AKTI 822

NR. VENDIMI 4373

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANE

Nr.13850/3268/822 Regj.Themeltar
Nr.4373 Vendimi

Dt 13.10.2017 Regjistrimi.
17.06.2019

Date

V E N D I M

“ NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere nga :

GJYQTAR : ARBEN MULLAJ

Asistuar nga sekretare gjyqesore Mersada Hyka, ne Tirane sot me date 17.06.2019 mori ne shqyrtim ne seance pregatitore Çeshtjen Civile qe i perket :

PADITESE : ***, i lindur ne Korce, me 01.10.1942, banues ne Tirane, me adrese Rr.Sulejman delvina, Pll 10, kt 2, nr 3 (Prane Media Print) Tirane.Perfaqesuar nga Av. Ilian Qeleshi dhe Av.Erion Kanxheri.

E PADITUR: ***, i biri i *** dhe i ***, i lindur ne ***, me ***, banues ne ***, përfaqësuar në gjykim nga Av. ***.

***, banues ne ***, përfaqësuar në gjykim nga Av. ***.

***, Rr. ***. (ne mungese).

OBJEKTI : Detyrimin e paleve te paditura solidarisht te paguajne demin pasuror dhe jo pasuror te shkaktuar per shkak te shkeljes te te drejtave te autorit.

Publikimin e Vendimit te Gjykates me shpenzime te paleve te paditura ne media.

Ndalimin e botimit dhe shkaterrimin e te gjithë librave te botuar ose te gatshem per t'u hedhur ne treg.

BAZA LIGJORE: Nenet 31,32, 153 e ne vijim K.Pr.Civile, Neni 608, 609, 625, 626, 640 e ne vijim Kodit Civil, Ligji Nr 35/2016 “ Per te Drejtat e Autorit dhe te Drejtat e tjara te Lidhura me to”.

Ne perfundim te gjykimit palet kerkuan :

Pala paditese: Pranimin e kerkese padise.

Pala e paditur: Rrezimin e kerkeses padise.

I padituri *: Ne mungese.**

Gjykata pasi shqyrtoi naktet e bisedoi ne teresi ceshtjen,

V E R E N:

Pala paditese, *, me kerkese padi drejtuar kesaj Gjykate, ka kekruar si me siper.**

Gjate shqyrtimit gjyqesor te ceshtjes rezultoi se :

Paditesi, *, eshte profesor ne fushen e Historise dhe autor i cili ka botuar dhjetra libra ne lidhje me profesionin e tij, libra te cilat jane te perhapura per publikun qe prej momentit te botimit te tyre.**

Nje prej librave qe paditesi ka botuar, se bashku me autore te tjere eshte edhe libri * per arsimin e mesem te profilizuar, profili shoqeror, ne bashkeautoresi me ***, ***, ***, ***, ***. Ky liber eshte botuar ne vitin 2006 dhe me heret ne disa botime te tjera.**

Ne kete liber, paditesi ka hartuar perkatesisht: Kreu I; Ne Kreun III mesimi 3.3; Ne Kreun IV mesimet 4.1 dhe 4.2; Ne Kreun V mesimet 5.4, 5.5, 5.6, 5.7 dhe 5.8; Ne Kreun VI mesimi 6.5; Kreun VII; Kreun XI; Kreun XII; Ne Kreun XIV mesimet 14.1, 14.2, 14.3, 14.4, 14.5, 14.7 dhe 14.8.

Paditesi ka rene ne dijeni disa muaj para hapjes se procesit gjyqesor te faktit se, palet e paditura kane botuar disa libra qe nga verifikimi i permbajtjes kane kopje te tekstit te paditesit. Konkretisht keto libra jane Historia 10, Historia e Qyteterimit Boteror 11, Historia e Qyteterimit Boteror 11. Keto tekste kane filluar te botohen nga viti 2010 e ne vijim dhe pasi jane verifikuar nga paditesi, sipas pretendimit te tij, eshte konstatuar se permblanin fjali, paragrafe dhe faqe te tera te kopjuara plotesisht nga teksti origjinal i paditesit.

Duke pretenduar se, paditesi i ka botuar me pare keto tekste dhe palet e paditura e kane botuar me vone dhe duke pretenduar se tekstet e mevonshme jane kopjuar nga teksti i meparshem, pala paditese iu drejtua Gjykates me kete kerkese padi.

Pretendimet e paleve :

Pala paditse pretendoi :

Sjellja e te paditurve eshte ne shkelje te ligjit dhe parimeve normale shoqerore, ku duke “vjedhur” krijimin e paditesit kane krijuar perfitime ekonomike dhe madje keto libra shperndahen ne shkollat e te gjitha Shqiperise. Nje element qe duhet te merret parasysh nga Gjykata eshte edhe fakti qe tekstet e palesse paditur jane tekste shkollore ashtu esic jane edhe tekstet e paditesit. Pra, qartesisht palet e paditura kane kopjuar tekstin e paditesit dhe e kane perdorur per ta konkurruar ate ne te njejten fushe per tekste te te njejtit qellim, qe jane tekstet shkollore.

Asnjehere paditesi nuk ju ka dhene te paditurve autorizim per perdorimin e librit te tij, qofte plotesisht apo pjeserisht. Pra, gjate gjykimit u provua plotesisht se paditesi nuk ka dhene asnje te drejte te ketyre teksteve paleve te paditura. Keto te drejta qe paditesi ka ne cilesine e bashkeautorit te ketij libri jane te mbrojtura nga legjislacioni shqiptar, qofte nga Kodi Civil si dhe nga legjislacioni i posacem, sic eshte Ligji Nr. 35/2016 “Per te Drejatat e Autorit dhe te Drejtat e Tjera te Lidhura Me To”.

Ne analize te dispozitave te K.Civil dhe Ligjit Nr. 35/2016 ne teresi eshte e qarte se paditesi eshte autor i nje vepre sic eshte ne kete rast libri shkollor, liber te cilin e ka publikuar shume me heret se palet e paditura dhe gezon mbi kete veper te drejta ekskluzive pasurore dhe jo pasurore dhe nga ana tjeter u provua se keto te drejta jane shkelur nga na a e pales se paditur, ne formen e kopjimit, perdorimi dhe nxjerrjes ne treg sikur te jete nje veper origjinale e tyrja.

Palet e paditura me faj kane perdorur vepren e paditesit dhe e kane perdorur per qellime fitimi, mbi te gjitha duke e perdorur si tekst shkollor per te gjitha shkollat e Shqiperise. Keto veprime te paleve te paditura jane absolutisht te paligjshme dhe kane cenuar rende paditesin si lidhje me deme pasurore, si fitimi i munguar dhe ne deme jopasurore, ku jemi ne rastin e nderit, personalitetit, reputacionit si dhe te drejtes se emrit te paditesit.

Gjate gjykimit u moren prova ne formen e akt ekspertimeve ne fushen gjuhesore dhe ate psikologjike. Nga keto ekspertiza ne menyre kategorike u provua se pala e paditur ka kopjuar tekstin e paditesit ne nje mase te madhe dhe thelbesore. Nga ana tjetere ekspertj psigologe znj. ***, ka arritur ne perfundimin se: “Vleresohet se ngjarja e ndodhur ka patur impakt negativ ne rrafshin psiko-emocional te z. **. ç...] Gjate vleresimit u konstatua dhe u vune re elemente ankthi dhe stresi gjate kohes qe ai tregonte rreth ngjarjes. (si dhe konkluzione te tjera te psikologur lidhur me ndikimin e ngjarjes ne marredhenien e tij familjare, nderpersonale si dhe me te trete). Gjithashtu ekspertja ka arritur ne konkluzionin qe nje shperblimi financiar ndaj paditesit do te ndikonte ne perceptimin e tij per “venien ne vend te drejtesise”.

Paditesi kerkoi pervec shperblimit te demit edhe publikimin e vendimit te Gjykates ne dy gazeta me shtrirje kombetare me shpenzimet e pales se paditur ne baze te nenit 167 te ligjit 35/2016.

-Per sa me siper pala paditese i kerkoi Gjykates pranimin e kerkese padise.

Pala e paditur prapsoi :

Objekti padise jane dy tekste ne bashkeautoresi, Historia e Qyteterimit Boteror 11 me autore Menduh Derguti dhe Tomi Treska, botim i Shtepise Botuese Albas, Tirane 2010 dhe teksti Historia e Qyteterimit Boteror (me zgjedhje te detyruar), 11 me autore, ***, ***, ***, botim i Shtepise Botuese *** Tirane 2012.

E gjithe padia eshte bazuar ne shkeljen e te drejtes se autorit kur autoresia e teksteve shkollore mbrohet nga e drejta e autorit, por niveli i mbrojtjes ka vlere zbatimi ne llojin e tekstit, i cili sipas akteve ligjore ndahet ne tekste Universitare, per te cilat eshte e detyrueshme bibliografia dhe referenca dhe ne tekste parauniversitare te cilat kane qene unike dhe te botuara para vitit 2005. Keto tekste, kane dale nga qarkullimi dhe jane vetem per perdorim publik dhe Altertekset qe jane futur ne qarkullim pas vitit 2005.

Me VKM-ne nr. 67 date 10.02.2010, Ministria e Arsimit dhe Kultures shpalli kurikulen per Altertekset ne vitin 2010 e ne vazhdim. Me daljen e alterteksit (tekstet alternative), te gjitha tekstet shkollore te meparshme dalin nga qarkullimi. Ne altertekset ne dallim nga tekset e meparshme, programi, tema e mesimit, ora e mesimit, problematika, struktura mesimore, kontributet institucionale dhe personale, vlera edukative, vijne ne perputhje me nje program te miratuar nga Ministria perkatese e Arsimit. Alterteksi ka si objekt perdorimi mesidhenien dhe mesimnxenien ne shkolle. Alterteksi permban me shume autore se sa jane autoret ne kopertine. Autoresia e Altertekteve nuk eshte si tekstet unike, per te cilat autoresine e ka patur shtepia botuese e librit shkollor.

Alterteksi, eshte programi i miratuar nga Ministria perkatese e Arsimit. E drejta e krijimit si pershtatje e gjetjeve shkencore te mirefillta e kontributeve institucionale dhe personale e vlerave edukative te veprave te spikatura ne perputhje me nje program te miratuar. Zbatimi ne konceptimin e Alterteksit si kopje e tere, si kapitull i plote deri ne

njesine baze qe eshte tema e mesimit, eshte per perdorim te mirefillte nga nxenesi dhe nuk eshte ne rrezen e mbrojtjes se autorit, pasi dhe referencat per burimet nuk kerkohen. Altertektet ngjajne se kane referenca te burimeve te njejta enciklopedike, botimeve akademike te perbashketa dhe punimeve shkencore, mbi data, fakte, ngjarje historike, emra figurash historike, permendie te vendeve, dhenie konkluzionesh apo tezash unike.

Teksti Historia 3 (Per arsimin e profilizuar shoqeror) botim 2001, ka dale nga qarkullimi dhe eshte per perdorim publik. Te gjitha tekset e dala nga qarkullimi jane materiale burimore dhe jane per perdorim publik, si burime informacioni. Ne librat shkollor dhe sidomos me daljen e Alterteksit ne vitin 2005, nuk e kane te deturueshme referencat mbi materialin burimor.

Faktet historike dhe te dhenat publike te perdorura ne te gjitha tekset unike shkollore para universitare jane gjetje dhe modifikim i teksshkruesit, nuk jane tema shkenecore, nuk jane veprat origjinale letrare, shkencore dhe artistikete, nuk jane dezertacion i ndonje autori, si te tilla nuk kane detyrim ligjor per referenca te materialit burimor.

Autoret e te gjitha teksteve te certifikuara qe kane qarkulluar dhe qe vijojne te qarkullojne ne shkollat e arsimit parauniversitar, jane mbeshtetur ne tekste dhe literatura te tjera te vendit dhe te huaja. Ne kete kuptim edhe vete paditesi dhe te paditurit nuk mund te konsiderohen autore te veprat origjinale letrare, shkencore dhe artistike, pasi altertektet dhe tekset shkollore parauniversitare nuk jane te tilla. Te vetmet tekste i mesimore me nje produkt te mirefillte kerkimor-shkencor ne kuptimin e zbatimit te kriterëve, standarteve dhe te prdorimit te detyruar me ligj te percaktimit te burimit shkencor jane tekstet Universitare.

Paditesi me cilesine e proves nuk depozitoi as edhe nje botim te tijin apo te cilit do autori, ne te cilin te ishin perfshire referencat burimore, bibliografive, etj. Paditesi edhe ne librat e tij te perdorura ne nje periudhe kohore para daljes se alterteksit (ne vitin 2010) nuk ka te vendosura materialet burimore te perdorura. Pra perfundimisht provohet se alterteksi nuk eshte subjekt i ligjit 35/2016, sepse ky ligj nuk e permban kete mbrojte.

Pala paditese nuk ka legjitimitet aktiv ne ngritjen e kesaj padije, pasi ne rastin konkret padia eshte ngritur kundrejt nje personi ndaj te cilit nuk duhej te ngrihej, sepse i padituri nuk ka lidhje fare me tekstin shkollor te paditesit Historia 3 per arsimin e mesem ,botim i shtepise botuese ***, botim i vitit 2006.

Per sa me siper pala e paditur I kerkoi Gjykates, rrezimin e padise si padi abuzive te pa mbeshtetur ne prova dhe ne ligj dhe gjobitjen e paditesit me nje nga format e parashikuara nga ligji, per padite abuzive.

Aresyetimi ligjor i Gjykates :

Nga ana e saj, Gjykata ne lidhje me kerkimin e objektit dhe bazes ligjore te kerkese-padise si dhe përpos shpjegimeve të palëve ndërgjyqëse çmon se referuar Nenit

6 të K.Pr.Civile percaktohet se: “Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”. Nga ana tjetër Neni 16/1 përcakton se “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dipsozitat ligjore..... Gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës. Në Nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrihen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.”.

Në kuptim të këtyre dispozitave gjykata në ushtrimin e veprimtarisë së saj, udhëhiqet gjithnjë nga ligji, nuk e paragjykon çështjen objekt gjykimi dhe u krijon palëve të gjitha hapësirat ligjore për të realizuar një proces të drejtë gjyqësor. Cilësimi juridik i fakteve bëhet në përputhje me cilësimin ligjorë të tyre.

Referuar fakteve të mosmarrëveshjes civile objekt gjykimi (për aq sa ato u provuan gjatë gjykimit), si dhe pretendimeve kontradiktore të palëve ndërgjyqëse, gjykata çmon se për zgjidhjen e drejtë në themel të kësaj mosmarrëveshje është e nevojshme që t’u jepet përgjigje disa çështjeve të rëndësishme juridike, që janë si vijon:

- 1. A ndodhemi perpara rastit te shkeljes se te drejtes se autorit?**
- 2. A përmbushen elementët e dëmit jo pasuror (jashtëkontraktor) në rastin konkret që përbën objektin e padisë në gjykim?**
- 3. A është rasti për caktimin e ndonjë shume të hollash me titull dëmshpërblimi për pësimin e një dëmi jo pasuror dhe nëse po, sa duhet të jetë kjo shumë e në ç’monedhë?**

Persa i perket ceshtjes se pare te shtruar per zgjidhje Gjykata veren se:

Neni 3 i Ligjit Nr. 35/2016 përcakton: “Te drejtat e autorit i perkasin, nga natyra, personit fizik, i cili ka krijuar vepren”.

Neni 8 i Ligjit Nr. 35/2016 përcakton: “Objekt i se drejtes se autorit eshte cdo krijim intelektual origjinal ne fushen e letersise, artit dhe shkences, i cili mbart karakteristika individuale, pavaresisht nga menyra ose forma e shprehjes se tyre, objektivi, rendesia, per aq sa nuk parashikohet ndryshe ne kete ligj. Veprat qe jane objekt i mbrojtjes se te drejtes se autorit jane si me poshte: (...) h) krijimet shkencore me shkrim ose me goje, sic mund te jene prezantimet, monografite, deduksionet, disertacionet, studimet, leksionet universitare, librat shkollore, projektet dhe dokumentacioni shkencor (...)”.

Neni 13 i Ligjit Nr. 35/2016 përcakton : “Autor eshte cdo person fizik ose nje grup personash fizike, qe krijon veper letrare, artistike, shkencore, produkt intelektual origjinal, i materializuar, pavaresisht nga forma dhe menyra e te shprehurit”.

Neni 17 i Ligjit Nr. 35/2016 përcakton: “Autoret gzojne te drejten e autorit mbi veprat e tyre, sipas parashikimeve te ketij ligji, per faktin e vetem te realizimit te krijimit. Per

ekzistencen dhe zbatimin e se drejtes se autorit nuk kerkohej asnje regjistrim i vepres ose formalitete te tjera”.

Neni 25/1 i Ligjit Nr. 35/2016 percakton: “Pervecse kur parashikohet ndryshe ne kete ligj, autori/trashegimtaret gezojne te drejta ekskluzive pasurore per te gezuar, autorizuar apo ndaluar perdorimin e veprave ose kopjeve te veprave te tyre”.

Neni 40 i Ligjit Nr. 35/2016 percakton: “Te drejtat vetjake jopasurore te autoreve mbrohen pa asnje kufi kohor. Pas vdekjes se autorit, mbrojtja e ketyre te drejtave merret persiper nga trashegimtaret ligjore dhe, ne mungese te tyre, behet sipas rregullave te percaktuara ne Kodin Civil”.

Neni 162/1, i Ligjit Nr. 35/2016 percakton: “Shkelja e te drejtave te njohura dhe te garantuara me kete ligj perben pergjegje si civile, administrative, kundervajtje ose pergjegjesi penale, sic mund te jete rasti, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi”.

Neni 163 i Ligjit Nr. 35/2016 percakton: “Mbajtesit e ligjshem te te drejtave te njohura e te garantuara ne baze te ketij ligji gezojne te drejten per t’i kerkuar gjykates respektimin e te drejtave te tyre nga cdo shkeles dhe ndermjetes, sherbimet e te cilit jane perdorur nga nje pale e trete per shkeljen e te drejtave qe gezojne, si dhe demshperblimin per demin e shkaktuar nga kjo shkelje”.

Neni 165 i Ligjit Nr. 35/2016 percakton: “Nese vertetohet se shkelja e ndonje te drejte, sipas ketij ligji, ka shkaktuar demtime, mbajtesi i se drejtes ka te drejte te kerkoje kompensim per demet, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi per kompensimin e demeve”.

Neni 166 i Ligjit Nr. 35/2016 percakton: “1. Nese nga perdorimi i paautorizuar i nje vepre te se drejtes se autorit ose i te drejtave te lidhura me te eshte shkelur e drejta e mbajtesit te se drejtes, ne baze te ketij ligji, ai ose nje AAK, qe administron te drejtat perkatese, mund te pretendojne shperblim, i cili do te ishte i barabarte me shperblimin per perdorim, sipas tarifave te permendura ne kete ligj. (...) 3. Nese shfrytezimi i paligjshem i ndonje te drejte, sipas ketij ligji, rezulton me perfitim, mbajtesi i se drejtes ka te drejte te kerkoje perfitimin e fituar nga personi fizik ose juridik qe e ka shkelur kete te drejte mbi nje veper te se drejtes se autori”.

Neni 172 i Ligjit Nr. 35/2016 percakton: “1. Per shkeljet, sipas ketij ligji, parashikimet e ketij ligji do te jene te zbatueshme ne perputhje me rregullat e legjislacionit ne fuqi qe rregullojne shkaktimin e demit. 2. Kundervajtesi, do t’i paguaje mbajtesit te se drejtes demet ne shumen qe do te percaktohet sipas rregullave ne fuqi per kompensimin/shperblimin e demit ose me shumen, per te cilen eshte rene dakord mes paleve, ose sipas shperblimit per perdorimin legjitim te asaj vepre. 3. Ne qofte se nje e drejte, sipas ketij ligji, eshte shkelur qellimisht ose nga pakujdesia e rende, titullari i se drejtes mund te kerkoje pagimin, per te cilin eshte rene dakort ndermjet tyre, ose shperblimin perkates per kete perdorim nga personi, i cili ka shkelur te drejten e tij, pavaresisht nese ai ka pesuar demtime per shkak te kesaj shkeljeje. 4. Ne kerkesen per

percaktimin e demeve dhe percaktimin e shumes se tyre, gjykata mban parasysh te gjitha rrethanat e rastit dhe, ne vecanti, shkallen e demit te shkelesit, shumen per te cilen eshte rene dakord ose shperblimin nga perdorimi legjitim i vepres”.

Per te provuar faktin se midis tekseve te pales paditese dhe te pales se paditur ka apo jo pjese te kopjuara, Gjykata bazuar ne nenin 224/a te K.Pr.Civile, urdheroi kryerijen e nje akti ekspertimi me ekspert gjuhesor. Sipas aktit te ekspertimit te ekspertes gjuhesore Znj. *** rezultoi se: “kemi konstatuar pjese te njejta dhe te ngjashme ne kapitujt 11 (124-151) dhe 12 (159-163) te librit Historia 3 (***,***,***...) dhe Linjes V (111-128) te librit Historia e qyteterimit boteror 11 me zgjedhje te detyruar (***,***,***).

Ne perqasjen mes Historia 3 (***,***,***) dhe tekstit Historia e Qyteterimit boteror 11 (***,***) kemi konstatuar pjese te njejta dhe te ngjashme ne kapitujt 4 (29-30, 32), 11 (155-157,164-165, 169-170, 139-143, 125- 127, 134-135, 126-133) dhe 12 (159-163) te librit Historia 3 (***,***,***) dhe Linjes 3 (19-110) Linjes TV (135-144, 151-158) te tekstit “Historia e qyteterimit boteror 11” (***,***).

Ne perqasjen mes Historia 3 (***,***,***) dhe tekstit Historia 10 (***,***,**,), kemi konstatuar pjese te njejta ose te ngjashme ne kapitullin 11 (139-141, 142-143, 145-146, 147-149, 155-157, 164-170) te librit Historia 3 (***,***,***) dhe Tematikes VI (150-153, 157-167) te tekstit Historia 10 (***,***...)”.

Per sa me sipër ne baze te provave dhe dispozitave te sipercituara rezulton se, librat e pales paditese futen ne kategorine e librave shkollore dhe jane prodhuar dhe futur ne qarkullim perpara librave te prodhuara nga palat e paditura. Sipas aktit ekspertimit te ekspertes gjuhesore Znj. *** rezultoi se, jane konstatuar pjese te njejta ose te ngjashme ne keto libra. Ne keto kushte Gjykata cmon se pala paditese gezon mbrojtjeje ligjore per librat e tij ne Ligjin Nr. 35/2016, “Per te Drejtat e Autorit dhe te Drejtat e Tjera te Lidhura Me To”, duke cmuar se jane shkelur te drejtat e autorit.

Për sa i përket çështjes së dyte të shtruar për zgjidhje, në nenin 625§1/a të Kodit Civil, parashikohet shprehimisht se: “Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur: a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cenuar në nderin e personalitetin e tij...”.

Lidhur me sa më sipër, gjykata vëren se legjislacioni civil shqiptar i ka krijuar dhe garantuar një mbrojtje të posaçme nderit dhe personalitetit të personit, duke e mbrojtur atë nga sjelljet e paligjshme që i cenojnë ato. Nderi në vetvete ka të bëjë me pastërtinë morale të dikujt, qëndrimin dhe sjelljen e virtytshme të tij, ndershmërinë dhe besnikërinë e tij. Po ashtu nderi është emri i mirë që gëzon dikush para të tjerëve dhe që përbëhet nga tërësia e vetive dhe tipareve morale të njeriut, që burojnë nga parime të caktuara, që çmohen nga shoqëria dhe që shfaqen në sjelljet e në veprimet që kryen personi konkret. Nga ana tjetër me personalitet kuptohet tërësia e veçorive psikike, të karakterit, të sjelljes, të veprimtarisë, etj, që e karakterizojnë dhe e dallojnë një person të caktuar nga personat e tjerë dhe që e vendosin një person në një pozicion të

rëndësishëm shoqëror.

Qëllimi i nenit 625§1/a të Kodit Civil, është që t'i garantojë mbrojtje juridike civile nderit dhe personalitetit të personit, që mund të dëmtohet nga sjelljet e dëmshme të të tretëve (pa bërë përjashtim këtu ndonjë kategori e caktuar qytetaresh, përfshirë edhe diplomatet). Ky nen siguron mbrojtjen civile të këtyre të drejtave të personit, ndërkohë që nuk përjashtohet edhe mbrojtja nga legjislacioni penal, në kushtet e parashikuara nga ky i fundit. Nderi dhe personaliteti i personit, siç u parashtrua më sipër, merret si e dhënë ekzistente për çdo person e cila përbën prezumim fakti, për sa kohë që nuk provohen fakte të tilla që të vënë në diskutim elementët e mësipërm.

Gjykata vëren se dëmi jo pasuror i parashikuar nga neni 625/§1/a i Kodit Civil, është një nga llojet e dëmit jashtëkontraktor. Koncepti i dëmit jashtëkontraktor jepet nga nenet 608 dhe 609 të Kodit Civil.

Neni 608 i Kodit Civil, parashikon se: “Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.”. Nga ana tjetër në nenin 609 të Kodit Civil parashikohet shprehimisht: “Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit. Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjanuar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar”.

Nga sa më sipër, gjykata konstaton se dëmi jashtëkontraktor përmban në vetvete katër elementë, të cilët duhet të bashkëveprojnë, në mënyrë që të ekzistojë ky lloj dëmi. Këto elementë janë:

Sjellja e paligjshme e shkaktuesit të dëmit jashtëkontraktor.

Ekzistenca e një dëmi të shkaktuar (që në rastin objekt gjykimi, lidhet me cenimin e nderit dhe personalitetit të personit).

Lidhja shkakësore midis sjelljes dhe dëmit të shkaktuar.

Faji (në formën e dashjes, pakujdesisë së rëndë ose pakujdesisë së lehtë).

Gjykata çmon se analiza e katër elementëve të parashtruar më lart, duhet bërë në linjë kronologjike, duke shqyrtuar nëse përmbushet secili element më vete. Për këtë qëllim, gjykata vijon me analizën e elementit të parë, që ka të bëjë me sjelljen e paligjshme të shkaktuesit të dëmit.

Në çështjen objekt gjykimi, ka rezultuar se paditesi është autor i një veprë sic është në këto rast librat shkollor, libra të cilët i ka publikuar shumë me heret se palet e paditura dhe gezon mbi këto veprë të drejta ekskluzive pasurore dhe jo pasurore dhe nga ana tjetër u provua se këto të drejta janë shkelur nga ana e pales së paditur, në formën e

kopjimit, perdorimi dhe nxjerrjes ne treg sikur te jete nje veper origjinale e tyrja. Gjykata vëren se sjellja e paligjshme e paleve te paditura, konsiston në shkeljen nga ana e saj, ne formen e kopjimit, perdorimit dhe nxjerrjes ne treg te librave te botuar e te nxjerre ne treg me pare nga pala paditese, sikur te jete nje veper origjinale e tyrja, duke cenuar nderin dhe personalitetin e një personi të caktuar dhe konkretisht paditesit. Pala paditëse, pretendoi se i është shkaktuar një dëm pasuror dhe jo pasuror si rrjedhim i përdorimit te librave te tij pa autorizimin e tij, që cenojnë nderin dhe personalitetin e tij, në botimet dhe nxjerrjen ne qarkullim te librave nga palet e paditura.

Në vendimin unifikues nr.10, datë: 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë parashikohet se: “Dëmi jopasuror, i parashikuar në nenin 625 të Kodit Civil, si një kategori e gjerë dhe gjithëpërfshirëse e dëmeve jashtëkontraktore, përfshin çdo lloj dëmi të pësuar nga cenimi i të drejtave dhe interesave jopasurore që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut dhe që nuk janë subjekt vlerësimi të drejtpërdrejtë ekonomik në treg. Në thelbin e saj, kjo dispozitë njeh të drejtën e dëmshpërblimit për çdo lloj dëmi jopasuror, jashtëkontraktor, i cili është “i ndryshëm nga ai pasuror”. Renditja e “rasteve” të dëmit jopasuror në paragrafet “a” dhe “b” të saj, nuk ka për qëllim të kufizojë, por të rregullojë në mënyrë të shprehur, për efekte të dallueshmërisë së cenimeve, të drejtën e dëmshpërblimit përkatës dhe rrethin e subjekteve që gëzojnë legjitimim aktiv.

Në këtë kuptim, dispozita e nenit 625 të K.Civil bën dallimin ndërmjet dy grupeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që nuk kanë natyrë pasurore të mbrojtura prej saj në rast cenimi: “dëmtimi i shëndetit” (e drejta absolute për shëndetin, në kuptimin biologjik) dhe cenimi i “personalitetit” (tërësia e të drejtave absolute të personalitetit). Nisur nga natyra specifike e të drejtave që mbrohen, në paragrafin “a” dhe “b” të nenit 625, ligjvënësi ka parashikuar dy raste të posaçme të dëmit jopasuror në personalitetin e njeriut: “cenimi i nderit” dhe “fyerja e kujtimit të një të vdekuri”.

Sipas doktrinës e praktikës sonë gjyqësore dhe asaj ndërkombëtare, dëmtimi i shëndetit është figurë autonome e dëmit jopasuror, e ndryshme nga dëmi pasuror për “humbjen dhe pakësimin e aftësisë për punë” (neni 641 i K.Civil). Ndërsa në grupimin e dytë përfshihen dy figura të dëmit jopasuror, autonome nga njeri-tjetri, dëmi moral dhe dëmi ekzistencial.”.

Nga ana tjetër në këtë vendim përcaktohet edhe kuptimi i konceptit dëm moral, si vijon: “Dëmi moral (pretium doloris ose pecunia doloris) është shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit të padrejtë (non iure perturbatio) të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror që

rrjedh si pasoje e faktit të paligjshëm. Cilido që pëson cenime në sferën e shëndetit dhe të personalitetit të tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj të një të treti ka të drejtën të kërkojë edhe dëmshpërblimin e dëmit moral të pësuar. Kjo e drejtë, në cilësinë e të dëmtuarit, i përket individualisht (ius proprius) edhe secilit prej familjarëve të afërt të personit që ka humbur jetën apo të cenuar në shëndetin e tij nga fakti i paligjshëm, nëse vërtetohet lidhja e tyre e posaçme familjare, ndjesore dhe e bashkëjetesës. Dëmi moral i pësuar nga vetë të afërmit konsiderohet si pasojë, rrjedhim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i të njëjtit fakt të paligjshëm.

Barra e provës për vërtetimin e dëmit moral është e paditësit. Por, nisur nga natyra subjektive e këtij dëmi dhe veçanërisht nga karakteri, shfaqja e brendshme e tij, vërtetimi i cenimit të personalitetit të të dëmtuarit në turbullime, dhimbje e vuajtje shpirtërore, etj, nuk mund të provohet në mënyrë tjetër përveçse duke i vlerësuar ius receptum si të mbështetura ligjërisht dhe duke i çmuar si të provuara ipso iure me vërtetimin nga paditësi të vetë faktit të paligjshëm të të tredit dhe lidhjes së këtij fakti me cenimin moral të pësuar, sipas parimit të rregullshmërisë shkakësore. Duke qenë provë në formën e prezumimit të thjeshtë, nëse shkaktuesi i dëmit nuk arrin të vërtetojë të kundërtën, ajo merr të njëjtën vlerë e fuqi të plotë provuese sikurse prezumimi ligjor iuris tantum (neni 13 i K.Pr.Civile).”

Në rastin konkret gjykata vëren se ka rezultuar se paditësi është autor i librave sic janë në këto rast librat shkollor, libra të cilet i ka publikuar shumë me heret se palet e paditura dhe gezon mbi këto vepra të drejta ekskluzive pasurore dhe jo pasurore dhe nga ana tjetër u provua se këto të drejta janë shkelur nga ana e pales së paditur, në formën e kopjimit, perdorimit dhe nxjerrjes në treg sikur të jete nje veper origjinale e tyrja. Gjykata vëren se sjellja e paligjshme e paleve të paditura, konsiston në shkeljen nga ana e saj, në formën e kopjimit, perdorimit dhe nxjerrjes në treg të librave të botuar e të nxjerre në treg me pare nga pala paditese, sikur të jete nje veper origjinale e tyrja, duke cenuar nderin dhe personalitetin e një personi të caktuar, konkretisht pales paditese.

Sipas akt-ekspertimit të ekspertës psikologje znj. ***, ajo ka arritur në përfundimin se: “Vlerësohet se ngjarja e ndodhur ka patur impakt negativ në rrafshin psiko-emocional të z. ***) Gjatë vlerësimit u konstatua dhe u vërejtën elemente ankthi dhe stresi gjatë kohës që ai tregonte rreth ngjarjes (si dhe konkluzione të tjera të psikologes lidhur me ndikimin e ngjarjes në marrëdhënien e tij familjare, nderpersonale si dhe me të tjerë). Gjithashtu ekspertja ka arritur në konkluzionin që një shpërblimi financiar ndaj paditësit do të ndikonte në perceptimin e tij për “vënie në vend të drejtësisë”.

Si përfundim, në lidhje me elementin e parë të shkaktimit të dëmit, që ka të bëjë me

sjelljen e paligjshme, gjykata konstaton se sjellja e paligjshme e paleve te paditura, qe konsiston në shkeljen nga ana e saj, ne formen e kopjimit, perdorimit dhe nxjerrjes ne treg te librave te botuar e te nxjerre ne treg me pare nga pala paditese, sikur te jete nje veper origjinale e tyrja, duke cenuar nderin dhe personalitetin e një personi të caktuar, konkretisht pales paditese.

Më tej gjykata vijon me analizën e elementëve të tjerë të shkaktimit të dëmit jo kontraktor (jo pasuror).

Për sa i përket dëmit jo pasuror të shkaktuar, gjykata çmon se konceptet juridike të nderit dhe personalitetit të personit, përveçse kanë një natyre subjektive, kanë edhe reflektimet e tyre në botën objektive. Këto reflektime konsistojnë para së gjithash në emrin dhe imazhin e mirë që personat kanë në shoqëri.

Gjatë procesit gjyqësor, nuk rezultoi që paditësi, të kishte një reputacion jo të mirë në shoqëri. Paditësi ***, eshte profesor ne fushen e Historise dhe autor i cili ka botuar dhjetra libra ne lidhje me profesionin e tij, libra te cilat jane te perhapura per publikun qe prej momentit te botimit te tyre. Paditësi eshte autor i njohur dhe mban grada shkencore shume larta, Profesor Doktor. Paditësi ka nje karriere te gjate dhe te respektuar dhe ka mbajtur pozicione pune shkencore dhe ka kontribuar shume ne fushen e tij shkencore. Pala e paditur nuk paraqiti asnjë provë të kundërt në këtë drejtim. Për këtë shkak gjykata çmon se është cenuar nderi dhe personaliteti i paditësit dhe ky përbën dëmin moral që i është shkaktuar atij.

Në vijim të arsyetimit të elementëve të shkaktimit të dëmit jashtëkontraktor, gjykata çmon se në çështjen objekt gjykimi ekziston edhe elementi i tretë i shkaktimit të dëmit jo pasuror, që është lidhja shkakësore. Ka qenë pikërisht shkelja nga ana pales se paditur, ne formen e kopjimit, perdorimit dhe nxjerrjes ne treg te librave te botuar e te nxjerre ne treg me pare nga pala paditese, sikur te jete nje veper origjinale e tyrja, ne kundërshtim me Ligjin Nr. 35/2016, “Per te Drejtat e Autorit dhe te Drejtat e Tjera te Lidhura Me To”, ajo që ka shkaktuar dëmin jo pasuror të cenimit të nderit dhe personalitetit të paditësit.

Në lidhje me këtë element, në vendimin unifikues nr.10, datë: 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, përcaktohet se: “Në zbatim të nenit 609 të K.Civil për pranimin e përgjegjësisë civile jashtëkontraktore, duhet të vërtetohet lidhja shkakësore materiale ndërmjet sjelljes (veprimit a mosveprimit) së paligjshme e me faj dhe dëmit të

shkaktuar. Në vijim, për përcaktimin e dëmtimeve (cenimeve) konkrete që rrjedhin nga ky fakt i paligjshëm dhe caktimin e dëmshpërblimit përkatës, duhet të vërtetohet edhe lidhja shkakësore juridike ndërmjet tyre.”.

Në rastin konkret dëmi që i është shkaktuar paditësit është dëm moral, që vjen si rrjedhojë e cenimit të nderit dhe personalitetit të personit nëpërmjet shkeljes nga ana pales se paditur, ne formen e kopjimit, perdorimit dhe nxjerrjes ne treg te librave te botuar e te nxjerre ne treg me pare nga pala paditese, sikur te jete nje veper origjinale e tyrja, ne kundershtrim me Ligjin Nr. 35/2016, “Per te Drejtat e Autorit dhe te Drejtat e Tjera te Lidhura Me To”. Për të provuar ekzistencën e këtij dëmi (i cili prezumohet), mjafton edhe vetëm fakti i paraqitjes së padisë në gjykatë, ç’ka provon se cenimi i botës së brendshme të paditësit e ka detyruar atë t’i drejtohet me padi gjykatës për të rivendosur në vend të drejtën e cenuar. Lidhja shkakësore në këtë rast është e evidente.

Për sa i përket elementit të fajit, rezulton se pala e paditur, ka vepruar me faj, në formën e dashjes, për shkak se shkelja nga ana pales se paditur, ne formen e kopjimit, perdorimit dhe nxjerrjes ne treg te librave te botuar e te nxjerre ne treg me pare nga pala paditese, sikur te jete nje veper origjinale e tyrja, ne kundershtrim me Ligjin Nr. 35/2016, “Per te Drejtat e Autorit dhe te Drejtat e Tjera te Lidhura Me To”, pa autorizimin e pales paditese dhe i kane shkaktuar atij nje dem jopasuror si rrjedhoje e cenimit te nderit dhe personalitetit.

Çështja e trete e shtruar për zgjidhje në arsyetimin e këtij vendimi, ka të bëjë me faktin se sa duhet të jetë masa e dëmshpërblimit që duhet caktuar në çështjen objekt gjykimi.

Në lidhje me këtë, në vendimin unifikues nr.10, datë: 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë parashikohet se: “Në thelb, me dispozitën e nenit 608 të K.Civil dhe atë të nenit 18 të Dekretit nr.295, datë 15.09.1992 ligjvënësi parashikon mbrojtjen nga fakti i paligjshëm i të tretit të të drejtave të njeriut, posaçërisht të të drejtave subjektive (absolute a relative) të personalitetit dhe të pronësisë (reale), sikurse janë e drejta e jetës, shëndetit, personalitetit, dinjitetit, familjes, jetës private, pronës, etj. Në rast të cenimit të këtyre të drejtave nga fakti i paligjshëm, i dëmtuari gëzon të drejtën subjektive relative të kërimit të dëmshpërblimit jashtëkontraktor.”

Më tej në këtë vendim përcaktohet se: “Shuma e dëmshpërblimit për dëmin moral, për shkak të natyrës subjektive dhe të brendshme të tij, nuk mund të llogaritet mbi tabela dhe skema të parallogaritura vetëm për këtë qëllim. Prandaj, gjykata e cakton atë

mbështetur në parimin e dhënies së drejtësisë sipas bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre, duke u mbështetur edhe në kritere eventuale normative të zbatueshme sipas natyrës së të drejtës së cenuar ose, në mungesë të tyre, në kritere dhe elementë vleresimi të konsoliduar nga praktika gjyqësore në zgjidhjen e çështjeve analoge ose në përvoja përkatëse jashtëgjyqësore, duke patur gjithnjë parasysh zhvillimin aktual ekonomik e social të vendit, përfshirë vlerën e parasë në ekonominë kombëtare.”

Neni 626 I K.Civil parashikon: “Kur demi eshte shkaktuar nga shume persona se bashku, keta pergjigjen ndaj te demtuarit solidarisht”.

Lidhur me sa më sipër, për sa i përket faktit se kujt duhet t’i njihet e drejta e dëmshpërblimit, gjykata çmon se kjo e drejtë i përket paditësit, padia e të cilit rezultoi e mbështetur në ligj dhe në prova gjatë procesit gjyqësor. Lidhur me masën e dëmshpërblimit, paditësi, i kërkoi gjykatës që të caktonte shumën prej 3.000.000 leke (tre milion).

Neni 625/1 i Kodit Civil, nuk ka përcaktuar ndonjë mënyrë për përcaktimin e shumës së të hollave që mund të caktohen, me titull dëmshpërblimi për dëmin jo pasuror. Në këto kushte, siç është theksuar edhe më sipër, legjislacioni ynë, e ka lënë një element të tillë në çmim të gjykatës, e cila cakton shumën e përshtatshme, pas vlerësimit të rrethanave të çdo çështje, rast pas rasti.

Gjykata çmon se shpërblimi për dëmin jo pasuror, përgjithësisht ka një karakter simbolik dhe synon që të kompensojë cenimin e nderit dhe personalitetit të personit. Në të vërtetë, asnjë shumë parash nuk do të ishte e mjaftueshme, për të kompensuar një dëm të tillë, ndaj për këtë arsye gjykata çmon se dëmshpërblimi në të holla, në shumicën e rasteve ka një natyrë simbolike. Mirëpo, nga ana tjetër, masa e dëmshpërblimit duhet të jetë e tillë që të nxjerrë në pah rëndësinë e shkeljes dhe të ndërgjegjësojë palët e gjykimit. Në rastin konkret, për caktimin e shumës së dëmshpërblimit gjykata mban parasysh elementët e mëposhtëm:

Caktimi i dëmshpërblimit i referohet vetëm faktit se shkelja nga ana pales se paditur, ne formen e kopjimit, perdorimit dhe nxjerrjes ne treg te librave te botuar e te nxjerre ne treg me pare nga pala paditese, sikur te jete nje veper origjinale e tyrja, ne kundershtim me Ligjin Nr. 35/2016, “Per te Drejtat e Autorit dhe te Drejtat e Tjera te Lidhura Me To”, pa autorizimin e pales paditese, i kane shkaktuar atij nje dem jopasuror si rrjedhoje e cenimit te nderit dhe personalitetit.

Paditesi ka nje status te caktuar shoqeror dhe per te arritur kete ka investuar mjaft pune e mund per nje periudhe disa vjecare.

Nderi dhe personaliteti i tij kurre nuk eshte cenuar, para se te te paditurit te shkelin te drejten e autorit te paditesit.

Përveç sa më sipër, gjykata mban parasysh në caktimin e masës së dëmshpërblimit edhe tërësinë e rrethanave të provuara gjatë gjykimit, të para në kompleksitet dhe të lidhura ndërmjet tyre.

Shuma prej * leke, çmohet nga gjykata si një shumë e arsyeshme, për rrethanat konkrete, si dhe kompleksitetin e kësaj çështje. Siç u tha më lart, pala e paditur, me veprimet e saj, i ka shkaktuar një dëm nderit dhe personalitetit të paditësit, duke cenuar në këtë mënyrë edhe emrin e mirë të këtij të fundit. Në caktimin e kësaj shume, gjykata mban parasysh se dëmshpërblimi që jepet, në rastin e shkaktimit të një dëmi jo pasuror, duhet të vendosë në vend cenimin që i bëhet nderit dhe personalitetit të një njeriu nga sa siper u relatuar.**

Gjithashtu me qellim minimizimin e demit qe i eshte shkaktuar paditesit Gjykata, bazuar ne nenin 617 te K.Civil, cmon se duhen detyruar palet e paditura të kryejne publikimin e vendimit te Gjykates ne dy gazeta me shtrirje kombetare me shpenzimet e pales se paditur.

Si përfundim, lidhur me sa më sipër, gjykata çmon se padia e paditësit * është e bazuar pjeserisht në ligj e në prova, ndaj për rrjedhojë duhet pranuar pjeserisht.**

PER KETO ARSYE :

Gjykata bazuar në Nenet 126, 306 e vijues të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S I :

-Pranimin pjeserisht te kerkese padise.

-Detyrimin e te paditurve *,***,***, ti paguajne paditesit ***, dmein pasuror dhe jo pasuror te shkaktuar per shkak te shkeljes se se drejtes se autorit, solidarisht ne**

Shumen * leke.**

- Publikimin e vendimit te Gjykates ne dy gazeta me shtrirje kombetare me shpenzimet e pales se paditur.

-Shpenzimet gjyqesore * leke, per taksen e padise, te parapaguara nga pala paditese i ngarkohen paleve te paditura solidarisht, ne shumen *** per aktin e ekspertimit psikologjik te parapaguara nga pala paditese i ngarkohen paleve te paditura solidarisht, ne shumen *** leke per flet thirrjet te pa paguara nga pala paditese i ngarkohen paleve te paditura solidarisht, per llogari te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.**

-Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 diteve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes se ketij vendimi. Per palen ne mungese ky afat fillon nga dita e nesërme e komunikimit te këtij vendimi.

-U shpall sot ne Tirane, me date 17.06.2019

**SEKRETARE
GJYQTAR**

**Mersada HYKA
Arben MULLAJ**

Shenim: Bashkëlidhur këtij vendimi leshohet urdhri i ekzekutimit per vendimin me Nr. 4373 date 17.06.2019 e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.